

20150612177

## **L I G J**

### **PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR**

#### Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14 dhe 20/15), në nenin 100 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në stazhin e sigurimit llogaritet edhe koha të cilën i siguruari e ka kaluar në marrëdhënie pune ose në vetëpunësim me orar të plotë të punës, për të cilin është përcaktuar lirim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë si vijon:

- deri në 36 muaj nëse i siguruari është në moshë deri 35 vjet;
- deri në 60 muaj nëse i siguruari është në moshë prej 35 deri 50 vjet;
- deri në 60 muaj nëse i siguruari është në moshë mbi 50 vjet;

- deri në 60 muaj për të siguarit të cilët janë prindër të tre ose më shumë fëmijëve, prindër vetëmbajtës dhe familje me një prindër, pranues të ndihmës sociale në para, fëmijë pa prindër dhe përkujdes prindëror, viktima të dhunës në familje, person invalid me invaliditet të caktuar në bazë të Ligjit për punësim të personave invalidë dhe personit me aftësi të punës të kufizuar ose pa aftësi profesionale për punë për 50% në pajtim me dispozitat e këtij ligji, ushtarët profesionalë të cilëve u ka pushuar marrëdhënia e punës në pajtim me Ligjin për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë dhe prindër të fëmijëve me pengesa në zhvillim shfrytëzues të shtesës së posaçme dhe

- deri në plotësimin e kushteve për pension të moshës të përcaktuar në këtë ligj nëse i siguruari është në moshë mbi 58 vjet."

#### Neni 2

Në nenin 118 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5) si vijon:

"(5) Me përjashtim të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni të siguarit nga neni 100 paragrafi (3) të këtij ligji janë në marrëdhënie pune ose persona të vetëpunësuar me orar të plotë të punës dhe për të cilët është përcaktuar lirim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, nuk janë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë pensionale për periudhën për të cilën është përcaktuar lirim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social."

#### Neni 3

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

#### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet për periudhën për të cilën është përcaktuar lirim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me Ligjin për plotësimin e Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 56/15).